

V E N D I M
Nr.9, datë 31.7.1995

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga :

Rustem Gjata,	Kryetar	i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar	i “““
Veli Budo,	Anëtar	i “““
Franc Jakova,	Anëtar	i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar	i “““
Metush Saraçi,	Anëtar	i “““
Zija Vuci,	Anëtar	i “““

me sekretare Drita Filto, më datat 21.7.1995 dhe 31.7.1995, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.13 Akti, që u përket :

KËRKUESA: 1.KONFEDERATA E SINDIKATAVE TË SHQIPËRISË, e përfaqësuar në gjyq nga Zv/kryetari i saj, Z. Xhafer Dobrusha, me akt përfaqësimi nr.91, datë 18.7.1995

2. BASHKIMI I SINDIKATAVE TË PAVARURATE SHQIPERISE, i përfaqësuar nga kryetari Z. Valer Xheka (në mungesë).

3. NEXHAT, FERDINAND E ZIJA PREKAZI, të përfaqësuar në gjyq nga Z. Hajdar Bajraktari me prokurë të posaçme nr.4075, datë 14.7.1994.

O B J E K T I

Shfuqizimin si antikushtetues të paragrafit të tretë të nenit 9 të ligjit nr.7916, datë 12.4.1995 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, për këto shkaqe :

Dispozita e këtij ligji shkel këto parime kryesore kushtetuese të shtetit tonë:

- Parimin e sanksionuar në dispozitat kryesore kushtetuese se, “në Republikën e Shqipërisë organet e vetme që japin drejtësinë janë gjykatat”.

Neni 9/3 i ligjit të lartpërmendur, duke i njohur pronarëve të drejtën e vënies në ekzekutim të vendimeve të “komisioneve të kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve” pa përfunduar gjykimi i çështjes nga gjykata, i ven këto vendime të organeve të administratës shtetërore mbi vendimet gjyqësore dhe nuk i përfill ato.

- Parimin e sanksionuar në ligjin “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut” dhe konkretisht në nenin 38 të këtij ligji ku thuhet se: “Liria, prona ose të drejtat e pranura me ligj nuk mund të cënohen pa një proces të rregullt ligjor”.

- Zbatimi i vendimeve të komisioneve të kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve, nxit dhe krijon artificialisht konflikte midis subjekteve në gjykim, krijon mundësi për dëmtimin e pronës, sepse zbatohet një vendim administrativ për ligjshmërinë e të cilit, do të vendosë vetëm gjykata.

Të njëjtat shkaqe kanë parashtruar edhe kërkuesit Prekazi, duke shtuar se vendimi i komisionit të kthimit të pronave është ekzekutuar forcërisht nga policia dhe pala kundërshtarë me të cilën jemi në gjyq ka sjellë në truallin objekt mosmarrëveshje materiale ndërtimi dhe ka filluar hapjen e themeleve për ngritjen e një godine.

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi dëgjoi relacionin përkatës,

V Ë R E N:

Shkaqet e parashtruara nga kërkuesit për shfuqizimin e paragrafit të tretë të nenit 9 të Ligjit Nr.7916, datë 12.04.1995 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin e kompensimin e pronave ish-pronarëve”, janë të drejta. Përmbajtja e kësaj dispozite : se procesi i kthimit të pronave ish-pronarëve nuk mund të pengohet, se vendimet e komisioneve të kthimit të pronave nuk mund të pezullohen as me vendim gjykate edhe kur ka filluar apo vazhdon procesi

gjyqësor, dhe se zbatohen vetëm vendimet e gjykatave që kanë marrë formë të prerë, nuk pajtohet me parimet themelore të organizimit tonë shtetëror mbi ndarjen e pushteteve, cënon pavarësinë e pushtetit gjyqësor, si edhe të drejtat e liritë themelore të qytetarëve.

Dispozita e sipërme, duke e ndaluar gjykatën, të pezullojë zbatimin e këtyre akteve administrative që i nënshtrohen kontrollit gjyqësor, i jep atyre fuqinë e titujve ekzekutivë, pa marrë ata formën e prerë për shkak se ka filluar ose vazhdon shqyrtimi gjyqësor, i kërkesave për anulimin e tyre.

Natyrisht që një gjendje e tillë është në kundërshtim të hapur me frymën që përshkon legjislacionin tonë procedural civil.

Por, ajo që e bën atë krejtësisht të papranueshme është karakteri antikushtetues i kësaj norme të ligjit në disa drejtime kryesore :

Në radhë të parë në dhunimin dhe mospërfilljen e parimeve të sanksionuara në nenet 1, 3 e 5 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”.

Këto janë parime themelore dhe kanë të bëjnë me organizimin tonë shtetëror të bazuar në ndarjen e pushteteve. Sipas dispozitave të sipërme të këtij ligji kushtetues pushteti gjyqësor është i pavarur nga pushtetet e tjera dhe ushtrohet vetëm nga organet e njohura nga ky ligj, që janë gjykatat, të cilat në veprimtarinë e tyre janë të pavarura dhe udhëhiqen vetëm nga ligji.

Nga ana tjetër, paragrafi i tretë i nenit 9 të ligjit nr.7916, datë 12.4.1995, duke i hequr gjykatës të drejtën e marrjes së masës së përkohëshme për ato çështje për të cilat ka filluar ose vazhdon procesi gjyqësor, e zhvesh atë nga një prerogativë e natyrshme e saj. Për rrjedhojë, pengohet ajo që të zhvillojë një proces të paanshëm dhe të rregullt ligjor.

Gjithashtu, cënohet edhe parimi themelor, që gjen pasqyrim në nenin 2 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese” si edhe në nenin 38 të ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”.

Në këto dispozita është parashikuar se “Gjykata është autoriteti që zgjidh çështjet dhe mosmarrëveshjet që lidhen me zbatimin e ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese” dhe të ligjeve nëpërmjet caktimit të dënimeve penale, të dëmshtëpërblimeve civile, të njohjes së të drejtave e detyrimeve të palëve, urdhërimit të masave për mbrojtjen e vendosjen e tyre, pas një procesi të drejtë, të barabartë dhe të rregullt ligjor, në pajtim me standartet ndërkombëtare” dhe se “liria, prona, ose të drejtat e pranuar me ligj, nuk mund të cënohen pa një proces të rregullt ligjor”.

Me paragrafin e tretë të nenit 9 të ligjit nr.7916, datë 12.4.1995 për kthimin e kompensimin e pronave, që i heq mundësinë gjykatës të pezullojë zbatimin e vendimit të komisionit të kthimit të pronave, vështirësohet ose bëhet i pamundur realizimi nga qytetarët i një prej të drejtave themelore të pretenduara, siç është e drejta e pronësisë, për shkak se rrezikohet që pasuritë e palujtshme të zhduken, të dëmtohen ose të tjetërsohen si dhe krijohen kushte për lindjen e konflikteve midis qytetarëve.

Me shfuqizimin e paragrafit të tretë të nenit 9 të ligjit nr.7916, datë 12.4.1995, nuk është e nevojshme të nxirret dispozitë tjetër, pasi nuk krijohet boshllëk ligjor (vocacio legis).

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në zbatim të nenit 24 pika3 dhe nenit 25/1 e 26/5 të ligjit 7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me unanimitet,

V E N D O S I:

Shfuqizimin e paragrafit të fundit të nenit 9 të Ligjit Nr.7916, datë 12.04.1995 “Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin Nr.7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”.

Masa e pezullimit të zbatimit të paragrafit të fundit të nenit 9 të Ligjit Nr.7916, datë 12.04.1995 mbetet në fuqi.

Vendimi është përfundimtar dhe i formës së prerë.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin e tij në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 31.7.1995

